



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

Nr. Prot.  
7781

Tiranë, më 16.08.2017

UDHËZIM

NR. 18 DATË. 16.08.2017

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 15, DATË 19.05.2017 "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2017 -2018"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, dhe pikës 4 të nenit 9 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"

UDHËZOJ

- I. Titulli i Udhëzimit nr. 15, datë 19.05.2017 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017 -2018", të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:  
*"Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2017 -2018"*.
- II. Pas Kreut VI të Udhëzimit, shtohet Kreu VI/1, si më poshtë:

*"Kreu VI/1*

*Procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet eciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017 - 2018.*

1. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve

me karakter profesional si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018, kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, nga data 7 shtator 2017 deri në datën 19 shtator 2017.

2. Kandidatët që aplikojnë në IAL, për program të dytë studimi apo transferim studimesh kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.
3. Kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin nr.346, datë 19.04.2017 të Këshillit të Ministrave, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.
4. Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh apo për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM.
5. Nuk mund të pranohen aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Kandidatët që aplikojnë për transferim të studimeve apo për program të dytë studimi duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit për të cilët aplikojnë. Kandidati nuk duhet të jetë duke ndjekur një tjetër program studimi.
6. Aplikimi për transferim studimesh, mund të bëhet nga një program studimi i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël edhe lloj, të ndjekur nga kandidati në IAL-të publike ose në IAL-të jopublike të licencuara dhe të akredituara për programin përkatës të studimit, vendase apo të huaja.
7. Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë për transferim të studimeve, paraqesin, pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve, dokumentet si më poshtë:
  - a. Kërkesa drejtuar IAL-së për programin e studimit, në të cilin do të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës nr. 9);
  - b. Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse;
  - c. Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur.

Studentët që transferojnë studimet e tyre nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse dhe listën e notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, duhet t'i dorëzojnë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin;
  - d. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në Drejtorinë Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;
  - e. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);
  - f. Dy fotografi personale.
  - g. Kopje e mandatë-pagesës.

8. Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në IAL (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet dhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL nga ku transferohet i cili përmban:
- i. Emri, Atësia, Mbiemri;
  - ii. Datëlindja;
  - iii. Vendlindja;
  - iv. Shtetësia;
  - v. Numri i matrikullimit që ka pasur në IAL – në përcjellëse;
  - vi. Emri i shkollës së mesme / IAL-së së kryer përpara ndjekjes së këtij programi studimi;
  - vii. ID e Maturës Shtetërore / nr. Regj. të veçantë<sup>1</sup>;
  - viii. Numri personal i identitetit;
  - ix. Data e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL - ja;
  - x. Emërtimi i programit të studimit dhe Fakulteti përkatës;
  - xi. Cikli dhe forma e studimit;
  - xii. Data e ndërprerjes së studimeve.
9. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi paraqet dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve:
- a. Kërkesa drejtuar IAL-së për programin e studimit, në të cilin aplikon për program të dytë studimi (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës 9);
  - b. Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve universitare të kryera më parë, të shoqëruar me suplementin e diplomës;
  - c. Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);
  - d. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në Drejtorinë Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;
  - e. Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);
  - f. Dy fotografi personale.
- Njohja e dokumentacionit të kandidateve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të se:nestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.
10. IAL shpall listat ekandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës 21 shtator 2017.

---

<sup>1</sup> Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2006

11. Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës 30 shtator 2017. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kriterëve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e Fakultetit të IAL-së, si dhe faqet web përkatëse, e plotësuar sipas Tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në Shtojcën nr. 10 të këtij udhëzimi.  
IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës 3 tetor 2017. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.
12. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.
13. IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 10 tetor 2017.
14. Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 10 tetor 2017 deri më datë 14 tetor 2017 sipas dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës 18 tetor 2017.
15. IAL-të brenda datës 21 tetor 2017 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.
16. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas Shtojcës nr.4 të këtij Udhëzimi."

III. Pas Kreut VI të Udhëzimit, shtohet Kreu VI/2, si më poshtë:

**"Kreu VI/2**

**Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në programet eciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017 – 2018.**

1. Kandidatët nga republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 21 - 26 Gusht 2017, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL. Kuotat e parashikuara për kandidatët me statusin e të verbrit, personave me aftësi të kufizuar, të paplotësuar janë të hapura për aplikimin për të gjithë kategorinë e kandidatëve persona me aftësi të kufizuar.
2. Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi, aplikojnë pranë IAL-ve respektive, deri më datë 26 Gusht 2017. Në të njëjtën datë, IAL-të shpallin listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në konkurs, e cila bëhet publike në mjediset e IAL-ve dhe faqet elektronike zyrtare. Konkurset e pranimit zhvillohen nga data 28 - 30 gusht 2017.
3. Aplikimi të kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotësojnë kriterin e mesatares të përcaktuar në Vendimin nr.346, datë 19.04.2017, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018", si dhe plotësojnë kriteret shtesë të pranimit të vendosura nga vetë IAL-të për programet e studimit për të cilët aplikojnë. Përjashtohen nga kriteri i notës mesatare kandidatët që aplikojnë për ndjekjen e programeve të studimit me karakter profesional.
4. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.
5. Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, përpara aplikimit, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikon.
6. Aplikimi për programet e studimit në IAL dërgohet me postë pranë sekretarive mësimore ose depozitohet në zyrën e protokollit të njësive kryesore të IAL-ve.
7. Sekretaritë mësimore mbajnë regjistër për aplikimet e depozituara. Me depozitim të aplikimit, njësitë kryesore përlllogarit mesataren për çdo kandidat në përputhje me vendimin nr.346, datë 19.04.2017 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018". Për kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare njoftohen nga sekretaritë mësimore për ndërprerjen e aplikimit.

8. *Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:*
- a) *Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja:*
    - i. *Formulari i aplikimit sipas formatit të Shtojcës nr. 5.*
    - ii. *Kopje të dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton se diploma e arsimit të mesëm është njohur, të shoqëruar me fotokopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave.*
    - iii. *Në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së, deklaratën bashkëlidhur këtij udhëzimi (Shtojca 7) si dhe kopje të noterizuar në Republikën e Shqipërisë (dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nëse është lëshuar në gjuhë të huaj), të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet. Përlllogaritja e notave do të kryhet sipas Udhëzimit nr. 44, datë 21.08.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, i ndryshuar. Në rast se kandidati/ja ka përfunduar shkollën e mesme në Shqipëri, dorëzon kopje të noterizuar të Maturës Shtetërore;*
    - iv. *Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;*
    - v. *Dy fotografi;*
    - vi. *Kopje e mandat – pagesës.*
  - b) *Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian:*
    - i. *Formulari i aplikimit sipas formatit të Shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij Udhëzimi.*
    - ii. *Kopje të diplomës/Dëftesës dhe listës së notave.*
    - iii. *Në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së, deklaratën bashkëlidhur këtij udhëzimi (Shtojca 7) si dhe kopje të njësuar me origjinalin të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë kopje të njësuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)dhe dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në njësinë arsimore vendore (Drejtorinë Arsimore Rajonale /Zyra Arsimore) përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit.*
    - iv. *Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).*

- v. Dy fotografi personale.
- vi. Kopje e mandat-pagesës.

- c) Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 10 të këtij Kreu duhet të dorëzojnë edhe kopje të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje e njësuar me origjinalin e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).
- d) Kandidatët me statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 10 të këtij Kreu duhet të dorëzojnë edhe kopje të librezës së invalidit paraplegjik e tetraplegjik të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje e njësuar me origjinalin e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).
- e) Kandidatët me statusin e jetimit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 10 të këtij Kreu duhet të dorëzojnë edhe kopje të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.
- f) Kandidatët romë dhe egjiptianë, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 10 të këtij Kreu duhet të dorëzojnë edhe Vetë deklaram ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano – egjiptian. Për përzgjedhjen e kandidatëve romë dhe egjiptianë, IAL-të marrin edhe ekspertizën e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
- g) Në rastet e aplikimeve nga kandidatët nga kategori të tjera të personave me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.2 duhet të dorëzojnë edhe kopje të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

Njohja e dokumentacionit të kandidateve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

- 9. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të në datë 5 Shtator 2017 publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre zyrtare të internetit listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
- 10. Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit brenda tre ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehën me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

11. IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën 12 Shtator 2017, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
12. Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës 19 shtator 2017.
13. Pas datës 19 shtator 2017, sekretaritetë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.
14. IAL-të brenda datës 06 tetor 2017 përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.
15. IAL-të brenda datës 7 tetor 2017 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

IV. Pas Kreut VI të Udhëzimit, shtohet Kreu VI/3, si më poshtë:

**“Kreu VI/3**

***Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017 – 2018***

1. Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 12 - 19 Gusht 2017, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL.
2. Kandidatët shtetas të huaj duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe të jenë të pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk duhet të rezultojnë të regjistruar nënjë program tjetër studimi në IAL-te publike dhe/ose jopublike, të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.



3. Kandidatët shtetas të huaj, përpara aplikimit kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikon. Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.
4. Kandidatët shtetas të huaj që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM-në nr. 346, datë 19.04.2017.
5. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.
6. Studentët e huaj duhet të paraqesin pranë IAL-ve dokumentet e mëposhtme:
  - a. Formularin e aplikimit sipas shtojcës nr.7 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
  - b. Fotokopjen e dokumentit personal të identitetit.
  - c. Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe.
  - d. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).
  - e. Dy fotografi personale.
  - f. Kopje e mandat-pagesës.
  - g. Autorizimin për trajtimin e të dhënave personale sipas shtojcës nr.7 bashkëlidhur këtij Udhëzimi.
7. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të në datë 5 Shtator 2017 publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre zyrtare të internetit listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
8. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit brenda tre ditëve kalendrike nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.
9. IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën 12 Shtator 2017, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

10. Kandidatët regjistruhen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës 19 shtator 2017. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për tu regjistruar në një program tjetër studimi.
11. Pas datës 19 shtator 2017, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.
12. IAL-të brenda datës 06 tetor 2017 përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues.
13. Sekretaritë mësimore të IAL-ve do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.
14. Procedurat e regjistrimit për programet e përbashkëta të ciklit të parë dhe të dytë të integruar:
  - a. Zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në IAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplomë të përbashkët, të dyfishtë ose të shumëfishtë, në bashkëpunim me IAL te vendet e BE-se, kryhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuar nga vetë IAL-të.
  - b. Njohja e dokumentacionit të kandidateve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.
  - c. Kandidatët që aplikojnë në programet e përbashkëta të studimit e paraqesin aplikimin e tyre pranë IAL-se përkatëse. Të dhënat e tyre i dërgohen QSHA-së nga IAL-ja në përfundim të procesit të regjistrimit të aplikimeve. Pas zhvillimit të konkurseve/testimeve të pranimit, IAL-ja i dërgon QSHA-së listat e fituesve dhe të dhënat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për zhvillimin e procedurave të njohjes së diplomës.
  - d. Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm në institucione arsimore në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i përbashkët i integruar i studimit i ciklit të dytë i IAL-së ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i mbrojtjes së kësaj gjuhe sipas përcaktimeve të nenit 76, pika 4 të ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
  - e. Sekretaritë mësimore të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka

nënshkruar në regjistër; nuk ka të drejte të ndryshoje programin e studimit, për atë vit akademik.

- f. IAL-të brenda datës 7 tetor 2017 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matricullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matricullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

V. Pas Kreut VI të Udhëzimit, shtohet Kreu VI/4, si më poshtë:

**“Kreu VI/4**

***Pranimet në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve"***

- 1 Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike deri në datën 20 Tetor 2017 dhe në IAL-të jopublike deri në datën 27 Tetor 2017.
- 2 Brenda datës 24 Tetor 2017, IAL-të publike dhe brenda datës 31 Tetor 2017 IAL-të jopublike shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet eeb të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.
- 3 Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehën me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.
- 4 Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së publike deri në datën 30 Tetor 2017, dhe deri në datën 06.11.2017, pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së jopublike.
- 5 IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj eeb, listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 1 Nëntor 2017 për IAL-të publike dhe 08 Nëntor 2017 për IAL-të private.
- 6 Njësitë kryesore të IAL-ve, organizojnë procesin e pranimet dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë dhe verifikimin e dokumentacionit të pranimet sipas kuadrit ligjor në fuqi. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.
- 7 Pranimi, në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional”

dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura", në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017 - 2018, sipas kuotave respektive të deklaruara nga IAL-të, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga IAL-të, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kriterëve të përcaktuara paraprakisht dhe të bëra publike paraprakisht.

8. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që:
  - a. kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë, i cili rezultoi i licencuar dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose
  - b. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të akredituar. Në rast pranimit kandidati është i detruar të kryejë njësimin e diplomës pranë MAS brenda muajit dhjetor 2017.
  
9. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a. Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.
  - b. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësi përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësi përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).  
Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtorja e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësi përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave;
  - c. Formulari i aplikimit (sipas formatit të Shtojcës nr. 8, bashkëlidhur këtij Udhëzimi);
  - d. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);
  - e. Dy fotografi personale.
  
10. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:
  - a. Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës

- shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri. Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.*
- b. Curriculum Vitae;*
  - c. Deklaratën sipas Shtojcës nr.7 të këtij udhëzimi.*
11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:
- a. Kandidati me statusin e të verbrit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).*
  - b. Kandidati me statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së invalidit paraplegjik e tetraplegjik të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje e noterizuar e vendimit të KMCAP.*
  - c. Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.*
  - d. Kandidati Rom dhe Ballkano-Egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është Rom apo Ballkano-Egjiptian.*
12. *Pranë departamenteve të njërive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (Statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.*
13. *Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë Udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.*
14. *Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA pas verifikimit i kërkon IAL-ve ta çregjistrojë atë.*
15. *IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshëm për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecursisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.*
16. *IAL-të brenda datës 15 nëntor 2017 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me*

qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

17. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas Shtojcës nr.7 të këtij Udhëzimi."

VI. Pas Kreut VI të Udhëzimit, shtohet Kreu VI/5, si më poshtë:

#### **"Kreu VI/6**

**procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017 - 2018**

1. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, nga data 7 shtator 2017 deri në datën 19 shtator 2017.
2. Kandidatët që aplikojnë në IAL, për program të dytë studimi apo transferim studimesh kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.
3. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë për program të dytë studimi, kandidatët që:
  - a. kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë "Bachelor", apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili rezulton i akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose,
  - b. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor", ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS.
4. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë për transferim studimesh të gjithë kandidatët që:
  - a. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germën "a" të pikës 3 të këtij kreu, në një program të ciklit të parë "Bachelor", apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë brenda ose jashtë vendit të akredituar në momentin e transferimit;
  - b. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor", apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë të akredituar në momentin e transferimit brenda ose jashtë vendit.

5. *Transferimi i studimeve në ciklin e dytë mund të bëhet në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël dhe lloj sipas kritereve të vendosura dhe shpallura publikisht paraprakisht nga IAL.*
6. *IAL-të nuk mund të pranojnë aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Transferimi i studimeve do të kryhet në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë udhëzim.*
7. *Kandidati që aplikon për program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:*
  - a. *Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.*
  - b. *Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).  
Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.*
  - c. *Formulari i aplikimit (sipas formatit të Shtojcës nr. 9, bashkëlidhur këtij Udhëzimi);*
  - d. *Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);*
  - e. *Dy fotografi personale.*
8. *Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:*
  - a. *Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.*
  - b. *Curriculum Vitae;*
  - c. *Deklaratën sipas Shtojcës nr.7 të këtij udhëzimi.*
9. *Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh:*

- a. Kërkesën drejtuar institucionit të arsimit të lartë (IAL) për programin e studimit, në të cilin kërkon të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit);
- b. Plani i plotë i programit të studimit nga ku transferohet;
- c. Vërtetim të listës së notave, krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer në ciklin e dytë të studimeve, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin eventual të lëndëve të programit të studimit të ndjekur, si dhe programeve/syllabuseve përkatëse të lëndëve të shlyera;

Kandidati duhet të paraqesë në momentin e regjistrimit dhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

- i. Emri, Atësia, Mbiemri;
- ii. Datëlindja;
- iii. Vendlindja;
- iv. Shtetësia;
- v. Numri i matrikullimit që ka pasur në programin e studimit të ciklit të parë;
- vi. Emërtimi i IAL-së dhe i programit të studimit të ciklit të parë, si dhe forma e studimit;
- vii. Numri i matrikullimit, si dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të dytë dhe fakultetit përkatës në IAL-në nga ku transferohet;
- viii. Cikli dhe forma e studimit;
- ix. Data e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja nga ku transferohet;
- x. Data e ndërprerjes së studimeve;

10. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi:

- a. Fotokopje e njëzuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë të diplomës universitare të ciklit të dytë të studimeve, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Për diplomat e fituara jashtë vendit, duhet të dorëzojë dhe vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS.
- b. Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse, vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse, nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse.

11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

- a. Kandidati me statusin e të verbrit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).
- b. Kandidati me statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së invalidit paraplegjik e tetraplegjik të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje e noterizuar e vendimit të KMCAP.
- c. Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.
- d. Kandidati Rom dhe Ballkano-Egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është Rom apo Ballkano-Egjiptian.



12. *Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (Statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.*
13. *Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë Udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.*
14. *Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA pas verifikimit i kërkon IAL-ve ta çregjistrojë atë.*
15. *IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshëm për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.*
16. *Komisionet respektive kryejnë renditjen e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh apo program të dytë studimi bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, dhe vlerëson kandidatët me statusin fitues/jo fitues. Këto të dhëna shpallen nga dekanati përkatës në ambientet e fakultetit dhe IAL-së, si dhe faqet web përkatëse, të plotësuara sipas Tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në Shtojcën nr. 11 të këtij udhëzimi, respektivisht, për kandidatët që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe për kandidatët që kanë aplikuar për program të dytë studimi.*
17. *IAL shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës 21 shtator 2017.*
18. *Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës 30 shtator 2017. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kriterëve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e Fakultetit të IAL-së, si dhe faqet web përkatëse, e plotësuara sipas Tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në Shtojcën nr. 9 të këtij udhëzimi.  
IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës 3 tetor 2017. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet*

me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

19. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.
  20. IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 10 tetor 2017.
  21. Regjistrimi i kandidatit, i cili mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 10 tetor 2017 deri më datë 14 tetor 2017. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës 18 tetor 2017.
  22. IAL-të brenda datës 21 tetor 2017 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.
  23. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas Shtojcës nr.7 të këtij Udhëzimi."
- VII. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, DAR/ZA-të, si dhe IAL-të, për zbatimin e këtij udhëzimi.

*Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare*

**MIRELA KARABINA**

  
**MINISTËR**



**Shtojca nr. 4**

**Deklaratë**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_

*emri atësia mbiemri*

me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë \_\_\_\_\_ Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.
2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.
3. Deklaroj se jam njohur me këtë udhëzim si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në të për të aplikuar për transferim studimesh/program të dytë studimi.
4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.
5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

\_\_\_\_\_  
Emër Atësi Mbiemër

i kandidatit

\_\_\_\_\_  
Emër Mbiemër

i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma

Firma

Vendi: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_\_

**Formular aplikimi**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_  
emri atësia mbiemri  
me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_

e-mail: \_\_\_\_\_, Tel: \_\_\_\_\_

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit \_\_\_\_\_ në IAL  
\_\_\_\_\_.

1. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët me kombësi shqiptare nga trojet (të shënohet me "x" vendi nga vjen kandidati):
  - Republika e Kosovës;
  - Mal i zi;
  - Maqedoni;
  - Preshevë;
  - Bujanovci;
  - Medvegja;
2. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.
3. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallej fitues për vitin akademik 2017-2018.
4. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.
5. Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.
6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër kandidatit

Firma

Formular aplikimi

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_  
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_, e-mail \_\_\_\_\_  
 celular \_\_\_\_\_.

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit \_\_\_\_\_ në IAL  
 \_\_\_\_\_.

1. Deklaroj se jam (të shënohet me "x" kategoria):
  - i/e verbër;
  - invalid paraplegjik / tetraplegjik;
  - të tjerë (PAK)
  - jetim;
  - Rom;
  - Egjiptian.
2. Autorizoj institucionet e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.
3. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallej fitues për vitin akademik 2017-2018.
4. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.
5. Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.
6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër kandidatit

Firma

**DEKLARATË**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_  
me kartë identiteti, pasaportë nr. \_\_\_\_\_,

1. Autorizoj Institucionin e Arsimit të Lartë \_\_\_\_\_, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj gjithashtu Institucionin e Arsimit të Lartë ku ka kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.
2. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në një nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues, për vitin akademik 2017-2018.
3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.
4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.
5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

\_\_\_\_\_  
Emër, Atësi, Mbiemër i kandidatit

\_\_\_\_\_  
Emër, Atësi, Mbiemër i punonjësit të sekretarisë  
mësimore

Firma:

Firma:

Vendi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_

**Formular aplikimi**

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_  
emri atësisë mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_ e-mail: \_\_\_\_\_, Tel:  
\_\_\_\_\_

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të dytë:

- Master profesional
- Master i shkencave/Master i arteve të bukura

në \_\_\_\_\_, në IAL \_\_\_\_\_

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse):

**A. Shtetas shqiptarë, brenda vendit**

**B. Kandidatë shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit (të shënohet me "x" vendi nga vjen kandidati):**

- Republika e Kosovës;
- Mal i zi;
- Maqedoni;
- Preshevë;
- Bujanovci;
- Medvegja;

**C. Nga kategoritë e veçanta (PAK, të shënohet kategoria e veçantë të cilës i përket kandidati):**

**D. Shtetas i huaj**

Gjuha amtare \_\_\_\_\_ Shtetësia \_\_\_\_\_

Emri i universitetit \_\_\_\_\_

6. Deklaroj se jam njohur me parashikimet e Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit për pranimet në vitin akademik 2017-2018 në ciklin përkatës të studimit.
7. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shitesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.
8. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Institucionin e Arsimit të lartë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet unioersitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

9. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.
10. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

---

*Emër Atësi Mbiemër*

*i kandidatit*

*Firma*

---

*Emër Mbiemër*

*i punonjësit që pranoi aplikimin*

*Firma*



**Formular aplikimi**

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_  
emri atësia mbienri

me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_ e-mail: \_\_\_\_\_, Tel: \_\_\_\_\_

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit (vendosni një rreth):

- me karakter profesional 2 – vjeçar
- ciklit të parë “Bachelor”
- integruar të ciklit të dytë “Master i shkencave”
- ciklit të dytë “Master profesional”
- ciklit të dytë “Master i shkencave” / “Master i arteve”

në \_\_\_\_\_, në IAL \_\_\_\_\_

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse):

**A. Për program të dytë studimi**

**B. Për transferim studimesh**

1. Deklaroj se jam njohur me parashikimet e Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit për pranimet në vitin akademik 2017-2018 në ciklin përkatës të studimit.
2. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.
3. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.
4. Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Institucionin e Arsimit të lartë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t’u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.
5. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

---

*Emër Atësi Mbiemër*

*i kandidatit*

---

*Emër Mbiemër*

*i punonjësit që pranoi aplikimin*

*Firma*

*Firma*

**Shtojca nr. 10**

**Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.**

Emër	Atësi	Mbiemër	Data lindje	Emërtimi i programit të studimit të kryer më parë dhe lloji (Bachelor, PICD)	IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit	Data e diplomimit në programin e parë të studimit	Emërtimi i programit të studimit ku aplikon për (Bachelor, PICD)	Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati	Kreditet e njohura	Kriteri 1	Kriteri 2	....	Pikët totale	Statusi i kandidatit	Fites/Jo fites
1															
2															
3															
....															

**Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.**

nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Data lindje	Emërtimi i programit të studimit nga transferohe	IAL-ja nga transferohe	Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik 2015-2016	Kreditet (ECTS) të grumbulluara	Emërtimi i programit	Viti i studimit ku transferohe	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit
												Kriteri 1	Kriteri 2	Pikët	Pikë totale	



**SHTOJCA nr. 11**

Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet dhe lloji IAL-ja nga transferohet	Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik 2015-2016	Kreditet (ECTS) të grumbulluara nga kandidati	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet dhe lloji	Viti i studimit ku transferohet	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit	Eftues/Jo ftues
											Kriteri 1	Kriteri 2	...	Pikët totale		

Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit (Cikli I)	IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë	Data diplomimit në programin e parë	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) ku aplikon për program të dytë dhe lloji	Viti i studimit ku mund të regjistrohet	Kreditet njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit	Eftues/Jo ftues
											Kriteri 1	Kriteri 2	...	Pikët totale		

